

ZHVILLIMI GJITHPËRFSHIRËS KRIJON IMPAKT NË SHQIPËRI

Aktivitetet në Shqipëri patën si qëllim përfshirjen e grupeve të ndryshëm të interesit, përfshirë gratë me aftësi të kufizuar, drejtues dhe përfaqësues të Organizatave me Aftësi të Kufizuar, stafin menaxhues dhe programativ të organizatave ndërkombëtare të zhvillimit si dhe drejtues e staf nga USAID-i.



Legjislacion dhe politika gjithpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuar

Promovim i botimit: "Studim dhe vlerësim i legjislacionit mbi aftësinë e kufizuar në Shqipëri"

Vodafone - Shqipëri, mbështetje për Personat me Aftësi të Kufizuar në nevojë për karrike me rrota

Intervistë me Albi Grevën
 Vodafone - Shqipëri

FËMIJET RRIKEN DHE ZHVILLOHEN, ATA NUK MBESIN PËRHERË TË VEGJËL



QENDRA PËR ZHVILLIMIN E SHANSEVE TË BARABARTA

Qendra për Zhvillimin e Shanseve të Barabarta do të zhvillojë aktivitetin e saj në qytetin e Shkodrës, si programi me i ri i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK).



Në këtë numër

Zhvillimi gjithpërfshirës krijon impakt në Shqipëri
Aktivitetet në Shqipëri patën si qëllim përfshirjen e grupeve të ndryshëm të interesit, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara, drejtues dhe përfaqësues të Organizatave me Aftësi të Kufizuara, stafin menaxhues dhe programativ të organizatave ndërkombëtare të zhvillimit si dhe drejtues e staf nga USAID-i. **Faqe 3**

Studimi i legjislacionit mbi aftësinë e kufizuar
Programi Ligjor pranë FSHDPAK me mbështetjen financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka ndërmarrë, së fundimi, si iniciativë kryerjen e një studimi mbi të gjithë kornizën ligjore në fushën e aftësisë të kufizuar në Shqipëri. **Faqe 5**

Rast. E quajne Zeqir Kurta, nuk është me shume se 39 vjeç por duket se ka marre mbi supe shume me shume vite... **Faqe 7**

Bizneset duhet të marrin shembullin e Vodafone në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara **Faqe 8**

Qendra për Zhvillimin e Shanseve të Barabarta do të zhvillojë aktivitetin e saj në qytetin e Shkodrës, si programi me i ri i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK). **Faqe 13**

Personat me Aftësi të Kufizuara, jashtë tregut të punës, barrë e familjes **Faqe 15**

Sfidoje veten dhe ndryshoje botën **Faqe 18**

Si të gatujmë **Faqe 20**

**ZHVILLIMI GJITHPËRFSHIRËS
KRIJON IMPAKT NË SHQIPËRI**
Aktivitetet në Shqipëri patën si qëllim përfshirjen e grupeve të ndryshëm të interesit, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara, drejtues dhe përfaqësues të Organizatave me Aftësi të Kufizuara, stafin menaxhues dhe programativ të organizatave ndërkombëtare të zhvillimit si dhe drejtues e staf nga USAID-i.



**Legjislacioni dhe politika
gjithpërfshirëse për personat
me aftësi të kufizuara**
Promovim i botimit: "Studim dhe
vizitimi i legjislacionit mbi aftësinë e
kufizuar në Shqipëri"

**Vodafone - Shqipëri,
mbështetje për Personat me
Aftësi të Kufizuara në nevojë
për kontrakt me rrotë**
Intervistë me Abis Grevin
Vodafone - Shqipëri

**FËMIJET
RITEN DHE
ZHVILLOHEN,
ATA NUK
MUSEN
PËRHERË TË
VEGJËL**



QENDRA PËR ZHVILLIMIN E SHANSEVE TË BARABARTA
Qendra për Zhvillimin e Shanseve të Barabarta do të zhvillojë aktivitetin e saj në qytetin e Shkodrës, si programi me i ri i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK).



Sfida 21

Revistë e përtremuajshme
Financuar nga:
Komiteti Suedez i Helsinkit për të
Drejtat e Njeriut

Swedish Helsinki Committee
for Human Rights

Bashkëpunëtorë:
Bardhylka KOSPIRI
Narbis BALLHYSA
Virxhil NANO
Entila ZYBA
Brikena DEMIRAS
Manjola ZEKA
Evis MIÇO
Shoqata e të verbërve të
Shqipërisë

Design and Layout
Grafika ELZANA

Adresa:
Rr.: "A.Z.Çajupi", (Bogdani),
Pallatet e reja "ENIL", K.3
Tiranë

Tel.: +355 4 269426;

E-mail: adrf@icc.al.eu.org

www.adrf.org.al

ZHVILLIMI GJITHPËRFSHIRËS KRIJON IMPAKT NË SHQIPËRI

Aktivitetet në Shqipëri patën si qëllim përfshirjen e grupeve të ndryshëm të interesit, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara, drejtues dhe përfaqësues të Organizatave me Aftësi të Kufizuara, stafin menaxhues dhe programativ të organizatave ndërkombëtare të zhvillimit si dhe drejtues e staf nga USAID-i.



Nga Cara Galbraith dhe Cindy Lewis

Përfaqësues të OPAK duke identifikuar fushat dhe çështjet me prioritet.

Njerëzit kudo në botë po e pranojnë se zhvillimi i shëndoshë përfshin njerëz me aftësi të kufizuara që nga politikëbërja deri në praktikë, se Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit mund të realizohen vetëm nëse ushtrohen praktikat e zhvillimit përfshirës dhe se strategjitë për zbatimin e varfërisë duhet të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara që në nivelin më bazë. Por, sa e kuptojnë njerëzit “zhvillimin përfshirës” në të vërtetë? Sa ndikojnë personat me aftësi të kufizuara si në zhvillimin e vendeve të tyre edhe në botë? Dhe cilat janë disa prej rrugëve për të filluar një proces të tillë? Këto çështje ishin në qendër të një projekti të mbajtur më së fundmi nga Mobility International USA (MIUSA). MIUSA është një

organizatë jo-fitimprurëse amerikane, misioni i së cilës është të fuqizojë personat me aftësi të kufizuara në botë për të arritur të drejtat e tyre nëpërmjet shkëmbimeve dhe zhvillimeve ndërkombëtare.

Një sërë workshop-esh, prezantimesh dhe seanca trainimi u zhvilluan në Tiranë, Shqipëri për një javë në maj të këtij viti si pjesë e projektit të MIUSA-s për Krijimin e një Komuniteti me Zhvillim Përfshirës. Projekti, i cili u mbështet me bujari nga **USAID** (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar) dhe u përfaqësua nga Fondacioni Shqipëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), është munduar që të rrisë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në programet e

zhvillimit ndërkombëtar të mbështetura nga USAID-i.

Aktivitetet në Shqipëri patën si qëllim përfshirjen e grupeve të ndryshëm të interesit, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara, drejtues dhe përfaqësues të Organizatave me Aftësi të Kufizuara, stafin menaxhues dhe programativ të organizatave ndërkombëtare të zhvillimit si dhe drejtues e staf nga USAID-i. Aktivitetet përfshinin një sërë workshop-esh dhe seanca trainimi, vizita në Organizatat për Personat me Aftësi të Kufizuara në Tiranë dhe Librazhd, një seancë për ngritjen e një rrjeti me përfshirjen e të gjithë aktorëve dhe konsultimeve individuale, si dhe takime me stafin e USAID-it dhe Partnerët Implementues të USAID-it.

Gjatë kësaj jave, përfaqësues nga mbi 25 Organizata për Persona



me Aftësi të Kufizuar (OPAK) ndanë të njëjtin vizion për një Shqipëri më të fortë dhe me te hapur, ku personat me aftësi të kufizuar angazhohen në mënyrë aktive si agentë dhe përfitues në të gjitha aspektet shoqërore dhe ekonomike. Drejtues dhe përfaqësues nga disa OPAK punuan në grupe duke komunikuar në tre gjuhë (shqip, anglisht dhe në gjuhën e shenjave) për të identifikuar strategjitë për aftësi kufizuese të ndryshme në fushat e Shëndetit, Rritjes Ekonomike, Arsimimit dhe Pjesëmarrjes Qytetare. Trainerët theksuan objektivat dhe prioritetet e programeve ndërkombëtare të



Drejtues të OPAK duke i kthyer
ëndrrat në realitet.

HAPAT DREJT ZHVILLIMIT PËRFSHIRËS

Në përfundim të aktiviteteve të javës në Shqipëri, MIUSA dhe FSHDPAK organizuan një seancë koordinuese ku partnerët implementues të USAID-it dhe përfaqësues nga OPAK patën rastin të mësonin rreth organizatave të njëri-tjetrit dhe të bënin plane specifike për bashkëpunim. Shumë procese janë vënë në lëvizje si rezultat i këtyre takimeve. Më poshtë do të shihni disa shembuj se si po ecën zhvillimi përfshirës në Shqipëri:

Pjesëmarrësit diskutuan shumë çështje praktike, ndër të cilat:

Si i ndimoj unë studentët e mi me aftësi të kufizuar në programin tim të trainimit për kompjuter që të mësojnë sesi të hapin bizneset e tyre të vogla apo të marrin mikro-kredi?

Si mund të ndihmojmë organizatat ndërkombëtare të zhvillimit të punësojnë dhe përfshijnë personat me aftësi të kufizuar në programet e tyre?

Si mund të sfidojmë mentalitetin e shoqërisë tonë dhe pikëpamjen e personave me aftësi të kufizuar dhe në të njëjtën kohë të jemi të mirëpritur në pozicionet vendim-marrëse dhe si drejtues komuniteti?

zhvillimit që operojnë aktualisht në Shqipëri. Ndërsa OPAK eksploruan prioritetet e tyre në kuadrin e zhvillimit ndërkombëtar, diskutimet u zhvendosën nga ëndrrat për të ardhmen në prospektivat konkrete për mundësi praktike, përmirësim dhe ndryshim.

Pas takimeve me OPAK, MIUSA dhe FSHDPAK patën rastin të takonin stafin dhe përfaqësues të programeve nga USAID si dhe partnerët e tyre implementues Amerikanë dhe Shqipëtar. Takimet u fokusuan në rritjen e të kuptuarit të zhvillimit përfshirës, dhe rishikimin e Politikës së USAID mbi Aftësinë e Kufizuar dhe Direktivat Politike respektive të Përvetësimit dhe

Asistencës.

MIUSA dhe FSHDPAK gjithashtu përcollën eksperiencën, çështjet dhe objektivat e diskutuara në takimet e OPAK.

Partnerët implementues të USAID ndanë mendimin se zhvillimi përfshirës ka sens. Grupi diskutoi strategjitë për të paraqitur praktika përfshirëse të aftësisë së kufizuar në strukturat dhe politikat organizative për punësim, komunikim dhe programe.

Për shembull, përfshirja e përfaqësuesve të OPSK si konsulentë dhe këshilltar në procesin planifikues me pjesëmarrje, si dhe si pjesëmarrës projekti, u identifikua si një praktikë kyçe.

- PSHM, një insitucion për dhënien e mikro-kredive në Shqipëri organizoi një vizitë në zyrat e tyre, dhe ka parashikuar asistencën e inxhinierëve nga Punishtja “Mirësia” për t’i bërë ambjentet e PSHM-së më të aksesueshme duke ndërtuar një ramp në hyrjen kryesore. Gjithashtu PSHM po planifikon të trainojë të gjithë stafin për të kuptuar implikimet positive ekonomike të zhvillimit përfshirës së aftësisë së kufizuar.

- Shoqata për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët bëri të ditur planet për lidhjen e personave me iniciativa për programe zhvillimi dhe fasilitimin e marrëdhënieve profesionale ndërmjet anëtarëve dhe partnerëve implementues të USAID-it. Shoqata do të marrë pjesë në një program trainimi për bizneset e vogla dhe do të takohet me institutin për dhënien e mikro-kredive për të mësuar lidhur me mundësitë për kredi me qëllim zgjerimin e shtypshkronjes së shoqatës. Gjithashtu, Shoqata to marrë pjesë në tenderat për projekt printimi/botimi për USAID dhe

partnerët implemtues të USAID.

Këta shembuj të bashkëpunimit ndërmjet OPAK dhe organizatave për zvitillim ndërkombëtar që operojnë në Shqipëri janë thjesht rezultat i projektit për *Ndërtimin e Komunitetit me Zhvillim Përfshirës*.

MIUSA dhe FSHDPAK po planifikojnë të ndjekin programin e trainimit në muajt e ardhshëm. Ju lutem na ndiqni për detaje të mëtejshme dhe mos hezitoni të na kontaktoni për idetë apo mendimet tuaja.

Projekti për Krijimin e Komunitetit me Zhvillim Përfshirës është mbështetur bujarisht nga USAID (Cooperative Agreement GEW-A-00-01-00012-00. ■



Për më shumë informacion lidhur me:

Projektin për *Ndërtimin e Komunitetit me Zhvillim Përfshirës* vizitoni www.miusa.org ose kontaktoni Cindy Lewis, Drejtore e Programit të MIUSA në clewis@miusa.org.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, vizitoni <http://www.adrf.org.al/en/> ose dërgoni e-mail në: adrf@abcom-al.com.

Për Politikën e USAID mbi Aftësinë e Kufizuar vizitoni: http://www.usaid.gov/about_usaid/disability/

Legjislacion dhe politika gjithpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara

Promovim i botimit: "Studim dhe vlerësim i legjislacionit mbi aftësinë e kufizuar në Shqipëri"



Programi Ligjor pranë FSHDPAK me mbështetjen financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka ndërmarrë, së fundimi, si iniciativë kryerjen e një studimi mbi të gjithë kornizën ligjore në fushën e aftësisë të kufizuar në Shqipëri. Botim, i cili u promovua me anë të një konference për shtyp,

realizuar në datë 1.09.2006.

Në objektivin e studimit tonë ishte vlerësimi me synim përmirësimin e legjislacionit të spektrit të aftësisë të kufizuar nëpërmjet krahasimit me legjislacionin bashkëkohor si dhe opinione, rekomandime në lidhje me përmirësimin e situatës të personave me aftësi të kufizuar.

Për të arritur qëllimet e tij, studimi u fokusua në të gjithë kornizën ligjore që parashikon të drejtat dhe detyrimet e personave me aftësi të kufizuar. Në këtë mënyrë pjesë e studimit u bë jo vetëm ligji themelor, Kushtetuta e RSH, ligjet organike dhe specifike por edhe vendimet dhe

rregulloret të cilat detajojnë më specifikisht këto të drejta.

Studimi është i ndarë në fusha të veçanta, duke filluar me kuptimin e termit Person me Aftësi të Kufizuar sipas Legjislacionit Shqipëtar, të dhëna statistikore, vlerësimi i aftësisë së kufizuar, Kushtetuta, Kodi i Familjes, Statuset, Ligji “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”, nr. 9355 datë 10.03.2005, e drejta për arsimim, e drejta për punësim, e drejta për të votuar, përshtatshmëria, e drejta për informim, ligji nr. 8092 datë 21.03.1996 “Për shëndetin mendor”, dhe për çdonjërën nga fushat janë paraqitur konkluzione përkatëse.

Disa nga rekomandimet me të rendesishme të këtij studimi janë:

- Ekziston nevoja për miratimin e një kuadri më të plotë ligjor që do të sigurojë të drejtat e të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet- politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore- mbi baza të barabarta..
- Duhet të synohet drejt miratimit të një ligji gjithëpërfshirës për të gjitha kategoritë e PAK në mënyrë që t'i jepet zgjidhje diskriminimit egzistues mbi baza statusesh (Statusi i invalidit të punës, Statusi i të verbërit, Statusi i paratetraplegjikut) dhe për të promovuar shanse të barabarta për personat me aftësi të kufizuar në zhvillimin social të vendit.
- Duhet të realizohet në një kohë sa më të shpejtë



database mbi të dhënat e PAK lidhur me numrin, llojin, kategoritë, diagnozat, shkaqet, frekuencën, përhapjen gjeografike, strukturën gjinore, në bazë të moshës së tyre, identifikimin e nevojave, llojet e shërbimeve dhe të identifikohen dhe të adresohen barrierat që PAK ndeshin gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.

- Duhet të përmirësohet legjislacioni lidhur me mënyrën dhe strukturimin e komisionit, rikomisio-nimit dhe vlerësimit të PAK.
- Përmirësim i kuadrit ligjor në fushën e arsimit, në të gjitha nivelet, përfshirë procedurat e pranimit, përshtatjen e kurikulave, shërbimet mbështetëse gjatë procesit mësimor për të zbatuar praktikisht arsimin gjithëpërfshirës.
- Rishikim i legjislacionit të punësimit si dhe përmirësim i politikave dhe programeve për trajnimin dhe formimin profesional.
- Përmirësim i legjislacionit në fushën ndërtimore, transportin rrugor, detar, ajror, hekurudhor, parashikimin e afateve dhe dispozitave sanksionuese për zbatimin e këtij kuadri ligjor.
- Legjislacioni Shqipëtar duhet të sigurojë ushtrimin e të drejtës për informim mbi baza të barabarta për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, në mënyrën më të përshtatshme për ta, si nga autoritetet publike, gjyqësore, media e shkruar dhe elektronike etj..
- Rishikim i legjislacionit si dhe standartizimin e shërbimeve komunitare dhe rezidencjale për personat me probleme të shëndetit mendor.
- Duhet të merren masa dhe të parashikohen dispozita më të forta sanksionuese në mënyrë që të vihet në zbatim kuadri ligjor në sferën e aftësisë së kufizuar.

Entila Zyba
Juriste, Koordinatore programi

Ne periferi te Qytetit te Korçes shtrihet nje fushe e madhe e cila eshte degjuar te thirret “ fusha e plehrave”.

Jo kujdo i ka rene rasti te shohe se çfare ndodh ne kete ane te Qytetit. Teksa i afrohesh te ben pershtypje nje re tymi qe ngrihet drejt qiellit dhe veshtrimi te pikezohet nga disa shtepi “kasolle” qe kane leshuar rrenje ne kete fushe.

Fillimisht nuk e kupton nese ka jete apo jo , por silueta femijesh shfaqen ne keto germadha, me tutje grumbuj mbeturinash qe lartsohen drejt qiellit sit e duan te bejne madheshtore prezencen e tyre.

Eshte e dhimbshme teksa sheh nje pamje te tille, dhe nuk e kupton se ku je me te vertete. Nje siluete shfaqet ne nje nga hyrjet e ketyre kasolleve. E quajne Zeqir Kurta, nuk eshte me shume se 39 vjeç por duket se ka marre mbi supe shume me shume vite.

Zeqiri dhe familja e tij eshte pjese e komunitetit rom ne Qytetin e Korçes. Ishte takimi i pare me te. Afrohet drejt nesh paksa i kerrusur nga njera ane dhe na pershendet. Ne gjithë pamjen e tij semundjet kane lene shenjat e tyre, veshtrimi i tij nuk thote asgje. Me duket i lodhur, pa shprese. Kush isha une dhe çfare beja aty, mbase kjo pyetje e mundonte ate, po ashtu edhe mua. Nuk e dija sesi mund ta ndihmoja.

Personi qe me shoqeronte shqetesoj shume per problemet e tyre dhe ishte ai qe ma kishte bere present problemin. Zeqiri vuante pervec te tjerave nga diabeti



militues, semundje e cila e dobesonte nga dita ne dite dhe kishte nevojë te menjehershme te trajtohej. Ai jetonte me vajzen e tij te vetme e cila ishte me aftesi te kufizuar te plote ne te folur. Nuk punonte se nuk mundej, nuk merrte as perkrahje nga shteti, dhe as nuk trajtohej nga sigurimet shoqerore apo nga KMCAJ, duke mos perfituar keshtu as statusin e invalidit apo personit me aftesi te kufizuara. Zeqiri na tregoi se rezultonte i martuar por bashkeshortja e tij kishte kohe qe ishte larguar nga banesa bashkeshortore. Duke qene se ai nuk kishte asnje te ardhur tjetër, pasi ishte interesuar prane sigurimeve shoqerore, i ishte thene se mund te perfitonte pension familjar meqenese ishte i ve me gruan e pare dhe se meqenese martesja e tij e dyte kishte humbur qellimin e saj ai shprehu deshiren qe te divorcohej, me qellim perfitimin e pensionit familjar.

Nderkohe edhe vajza e tij me aftesi te kufizuar te plote ne te folur nuk perfiton asnje te ardhur sipas ligjit. Aq me teper qe nje ngjarje e papritur po trokiste ne jeten e tyre,



vajza e tij ishte shtatzene aksidentalisht, pra nje anetar tjetër i familjes po vinte ne jete. Pas takimit ne banesen e tyre vendosem dhe filluam procedurat e zgjidhjes se martesës ne Gjykate, aktualisht jemi ne perfundim te tyre.

Pas marrjes se Vendimit te zgjidhjes se martesës, forme te prere , Zeqiri do ndihmohet per te perfituar grup invaliditeti, si dhe nese eshte mundesia edhe pension familjar, per vete dhe vajzen e tij. I pyeta sesi mendonin ta organizonin jeten e tyre pas ardhjes se femijes, dhe ata ishin te dy te sigurt dhe na kerkuan ndihmesn e tyre per ta sistemuar beben ne shtepine e foshnjes pas lindjes se tij. U kontaktua me titullaren e Shtepise se Foshnjes me qellim akomodimin e femijes ne kete institucion pas lindjes. FSHDPAK Korçe, shpreson t’u kete ardhur sadopak ne ndihme familjes se Zeqir Kurtës.

*Evis Mico,
Juriste e Programit ligjor te
FSHDPAK ne Korçe*

Vodafone - Shqipëri, mbështetje për Personat me Aftësi të Kufizuara në nevojë për karriker me rrota

Intervistë me Albi Grevën Vodafone - Shqipëri



I pranishëm për tre vjet me radhë, Vodafone - Foundation përmes VODAFONE – Albania nuk i ka kursyer paratë për të ofruar ndihmë financiare ndaj punishtes “Mirësia”, që të prodhojë karrige me rrota për njerëzit me aftësi të kufizuara. Në radhë të parë, ndihma për njerëzit në nevojë është prioritet i kompanisë celulare, por integrimi i këtij komuniteti dhe vetë punësimi i këtyre personave në punishten ‘Mirësia’ është një tjetër pikë për të mbështetur filozofinë e bamirësisë. “Në këtë mënyrë ne mbajmë një flamur në dorë dhe nga bota e biznesit, të paktën, jemi vetmit që financojmë një projekt për karriget me rrota”, shprehet Albi Greva. Në një intervistë për “Sfidën”, ai shprehet se bashkëpunimi me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara do të vazhdojë edhe më tej.

I. Vodafone - Foundation përmes VODAFONE - Albania mbështet për të tretën herë radhazi projektin e prodhimit të mjeteve lëvizëse, në punishten “Mirësia”, program i FSHDPAK, në ndihmë të personave të varfër me aftësi të kufizuara. Përse u vlerësua nga VODAFONE si i rëndësishëm ky projekt social në ndihmë të kësaj kategorie?

Në radhë të parë, duke parë nevojat e mëdha që janë në Shqipëri për pajisjet e karrigeve me rrota për njerëzit me aftësi të kufizuara, kjo vetvetiu tregon që këtu ka një problem të madh. Dhe përgjegjshmëria jonë për këtë komunitet, indirekt vjen me mbështetjen e punishtes ‘Mirësia’ për prodhimin e karrigeve me rrota. Ky proces është në radhë të parë proces integruar. Nuk bëhet fjalë vetëm për një karrige, por kjo karrige i jep një njeriu me aftësi të

kufizuara lëvizje, i jep jetë, mundësinë për të shkuar te një libër, te një mik. I jep atij një shans për ta pranuar jetën më bukur dhe për ta jetuar më mirë çdo moment, siç themi ne në VODAFONE. Kjo është parë më shumë si asistencë për njerëzit në nevojë, por dhe për t’u dhënë atyre edhe integrimin në shoqëri, gjë e cila mungon dhe në të gjitha raportet, qoftë kombëtare, qoftë ndërkombëtare, apo edhe të fondacioneve që merren me këto probleme, tregojnë se nevojat janë ekstremisht të mëdha për këtë kategori. Është prioritet për ne gjithashtu sepse donatorët për këtë fushë janë shumë të kufizuara dhe numërohen me gishtat e dorës. Ne mendojmë se duke u bërë kontributorë në këtë fushë, ne mbajmë një flamur në dorë dhe nga bota e biznesit, të paktën, ne jemi vetmit që financojmë një projekt për karriget me rrota. Një aspekt tjetër shumë i mirë i projektit, është se nxit edhe punësimin e njerëzve që lëvizin me karrige me rrota. Një nga pikat për të cilat ne ishim optimistë kur kontaktuam me personat e fondacionit FSHDPAK, pikërisht për këtë arsye, sepse ka edhe një numër njerëzish me aftësi të kufizuara që janë të punësuar në punishten ‘Mirësia’, që u jep atyre mundësi të punësohen e të marrin të ardhura. Edhe kujdesi dhe puna në këtë mënyrë është më e kujdesshme, sepse ata janë njerëz që i njohin shumë mirë nevojat e këtij komuniteti. Në këtë mënyrë ne jemi shumë të kënaqur me punën e bërë. Unë dua të them që jo vetëm në këtë projekt, por edhe në të tjera që VODAFONE

financon, një nga arsyet e forta që ne nxitemi për të aprovuar fonde, është se ne kemi nevojë për partnerë të qëndrueshëm. Do të thotë që ne presim prej tyre që të realizojnë objektivat që ata vendosin, dhe njëkohësisht kthehen në krijues dhe e çojnë akoma më tej atë aplikim që bëjnë. Jemi të kënaqur me bashkëpunimin me FSHDPAK dhe mendojmë që është një demonstrim shumë i mirë i një partneriteti të qëndrueshëm. Mendojmë që do ta çojmë akoma më përpara këtë bashkëpunim. Ne krenohemi me punën që ata bëjnë për paratë që ne japi. Ky është vlerësim maksimal që ne mund të japim. Kemi dhënë një kontribut modest, por një gjë me vlerë për njerëzit në nevojë. Një tjetër pikë e

tij?

Së pari, është dhënia e mundësive nëpërmjet pajisjeve të karrigeve me rrota, për akses dhe integrimin e tyre në shoqëri. Nëpërmjet karriges i jep akses te njerëzit, te kultura, te zhvillimi. Gjëja më e mirë është që nëpërmjet karriges këta njerëz bëhen edhe kontributorë në shoqëri. Ata brenda tyre mund të kenë mundësi për të dhënë diçka. Unë e kuptoj shumë mirë këtë, dhe e gjithë kompania, ne edhe në degët e reja që kemi ndërtuar, konstruksioni i ndërtesës është bërë në mënyrë të tillë, që edhe tualetet, por edhe ambientet e tjera të punës të kenë akses edhe për njerëzit me aftësi të kufizuara. Kjo është në parimet dhe filozofinë e vetë kompanisë. E treta ne mendojmë

bërë.

4. Duke njohur nevojat e personave me aftësi të kufizuara për mjete lëvizëse dhe integrim në shoqëri, a mendoni se VODAFONE do të jetë në vazhdimësi i pranishëm në kontribute të tilla për këtë kategori në nevojë?

Ky është një nga pasionet dhe një kulturë në VODAFONE, është pasioni për botën që na rrethon. Komuniteti në nevojë është pjesë e shoqërisë që ne i shërbejmë. Kjo është shumë e rëndësishme, kjo është një nga moton kryesore që ne ndikohemi në momentet e aprovimit për të tilla projekte. Kjo ka siguri edhe për të ardhmen, ne jemi afër përfutjesve edhe për arsye që ne mendojmë se do të çojnë përpara këto iniciativa



fortë e këtij aplikimi është se ndihma për këta njerëz shkon në të gjitha skajet e Republikës, fondacioni hapet në të gjitha fijet e Shqipërisë, sepse ne e dimë që karriget me rrota shkojnë për të ndihmuar fëmijët, njerëzit e moshës së tretë, në Tiranë, Durrës, Vlorë, Lezhë, Laç, Kukësit, Gjirokastrës, pra një gjeografi e gjerë. Ne e dimë që ka edhe organizma të tjera ndërkombëtare që japin financimet e tyre, por në fushën e biznesit në vend, ne përbëjmë një risi. Dhe këtë e themi me shumë qejf, edhe pse është i treti vit radhazi që ne financojmë këtë projekt.

2. Çfarë të drejtash të personave me aftësi të kufizuara mendoni se ky projekt mbështet përmes zbatimit të

që i japim akses fizik, kjo është më e rëndësishmja.

3. Si e vlerësoni bashkëpunimin me FSHDPAK në arritjen e rezultateve të këtij projekti në dy vitet e mëparshme?

Bashkëpunimi është maksimal, për vetë faktin që ne e rrefinancojmë për herë të tretë, nuk ka nevojë për komente, është një projekt i suksesshëm. Dhe me një impakt direkt te jeta e njerëzve. Ato i kanë arritur gjithnjë objektivat dhe në kohë rekord, nëse hapësira kohore për realizimin e një objekti ka qenë 6 muaj, ato e kanë bërë për tre katër muaj. Jo vetëm kaq, por ne kemi një sistem vlerësimi për projektet dhe monitorimi dhe raportimi që e ndjekim me kujdes për punën e

5. VODAFONE, përmes financimit të projekteve të tilla sociale dëshmon aktivizimin e biznesit serioz në mbështetje të grupeve vulnerable në Shqipëri. Mendoni se iniciativa të tilla mungojnë apo janë të pakta në Shqipëri?

Iniciativa të tilla për mendimin tim janë sporadike në Shqipëri. Ka dy arsye, e para sepse bota e biznesit është e pirur në investimet e tij. Ka iniciativa sporadike aty këtu, por s'ka strategji të ndërtuar që t'u vijë në ndihmë njerëzve në nevojë. Duke qenë se VODAFONE, është një nga kompanitë dhe bizneset e suksesshme në Shqipëri ka përgjegjësinë edhe të luajë një rol drejtues dhe mendojmë që këtë jemi duke e bërë, qoftë në projekte të përbashkëta të këtij lloji, por edhe në projekte që ne financojmë vetë, ne kemi pasur shumë aktivitete të tilla në ndihmë të njerëzve në nevojë. Shoqëria zhvillohet si një e tërë dhe jo me cepa të veçantë, prandaj edhe këto iniciativa mund të merren si shembuj për të tjerët.

Brikena Demiras

Gazetare, gazeta "Panorama"

● ●
Eshtë folur dhe debatuar shumë për problemet e fëmijëve me nevoja të veçanta, për veçoritë dhe mënyrat e trajtimit të tyre. Në veçanti, e pasur është sot literatura me materiale për teknika dhe procedura të ndryshme mjaft efikase që ndikojnë në aftësimin fizik, mendor e psiko-shoqëror të personave me aftësi të kufizuara.

Të përqëndruar më shumë në këto drejtime, pa dyshim të rëndësishme, me dashje apo pa dashje, ndoshta edhe nga paragjykimet apo paaftësia jonë, kam përshtypjen se një pjesë e mirë e harkut kohor e jetës së personave me aftësi të kufizuara është disi më e neglizhuar. Shpesh harrohet që këta fëmijë zhvillohen, ata nuk mbeten

Nga:
Prof. Asoc. Dr. Virxhil Nano

përafërt me rreth 1 miliard e ca të rinj raportuar në popullatën totale të globit me mbi 6 miliard e ca banorë). Pra sic shihet kemi të bëjmë me një numër të konsiderueshëm personash të cilët duam nuk duam do të kalojnë edhe periudhën e adoleshencës, përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara. Bëhet fjalë për një periudhë të bukur të jetës, e cila krahas vlerave të mëdha që mbart, si një mënyrë e rinovimit të shoqërisë, nuk kalon për herë lehtë duke krijuar në familje edhe probleme jo të vogla.

Kur në një takim me prindër që kishin fëmijë me A.K, disa nëna

është koha kur të duket se “malet s’ të duken shumë të larta dhe lumenjtë mund ti kapërcesh lehtë”.

Për cdo individ adoleshenca sjell me vete emocione të cuditshme dhe përvoja të reja, por ajo mbart njëkohësisht edhe probleme. Kur dikush ka një aftësi të kufizuar, vetkuptohet se edhe shqetësimet janë më të mëdha. Këto bëjnë që i riu dhe familja e tij ta përjetojnë këtë periudhë si më të vështirë dhe me jo pak probleme.

Për të kuptuar se c’ndodh me personat që paraqesin nevoja të vecanta, mendoj se së pari duhet të kemi të qartë se c’ndodh me këtë të ri në këtë moshë. Cdo përpjekje për të gjetur një zgjidhje ndihmon për tu orientuar më mirë në marrëdhëniet tona me

Fëmijet rriten dhe zhvillohen, *ata nuk mbesin përherë të vegjël*

gjithmonë fëmijë, si gjithë të tjerët. Në fillim ata janë bebe, bëhen fëmijë, më pas adoleshentë, rriten, bëhen të moshuar dhe vdesin. Pavarësisht nga ngjyra e syve, e lëkurës apo e flokëve, cilat do qofshin besimet fetare apo aftësitë mendore, të gjithë ne pa përjashtim udhëtojmë në këtë cikël njerëzor të jetës. Etapat janë të parapërcaktuara. Sigurisht, gjithësecili i kalon sipas mënyrës së tij.

Mjafton të hedhim një shikim dhe vërejmë se fëmijët, nxënësit ndryshojnë, rriten dita ditës, një pjesë sapo kanë hyrë në periudhën e pubertetit dhe jo pak, tashmë janë adoleshentë. Sipas studimeve të bëra 19%-23% e popullatës së botës përjeton moshën e adoleshencës (shifër kjo e



nisën të ankoheshin për sjelljet e fëmijëve të tyre të vegjël, duke kërkuar në një farë mënyrë

ndihmë, një prind nga mesi i sallës nisi të qeshë dhe kur e pyetën se çfarë kishte ai iu drejtua nënave që kishin fëmijë të vegjël me A.K me këto fjalë: “*prisni edhe pak sa tu rriten pa do ta shikoni edhe ju ...*” dhe pas një heshtje të shkurtër shtoi duke thënë: “*...ato do tu rriten, do të bëhen adoleshentë dhe do ta shikoni sesa probleme do të keni me ta*”. Në momentin kur ky prind i tha prindërve të tjerë këto fjalë, fëmija i tij me A.K sapo kishte hyrë në periudhën e adoleshencës. Pa dashur të bëjmë komente, mesazhi është mjaft domethënës. Cdo moshë ka veçoritë e veta, por në vecanti adoleshenca përbën për njeriun një periudhë të vecantë. Është me të vërtetë një lindje e dytë, sa e vrullshme aq edhe romantike,



personat me aftësi të kufizuara, kontribuon për njohjen më të mirë të karakteristikave të tyre në këtë periudhë të vullshme të zhvillimit.

Pa pretenduar të trajtojmë gjithëcka në këtë artikull do përpiqemi të evidentojmë më poshtë disa momente sinjifikative për problemin që trajtojmë.

Së pari, nënvizojmë idenë se adoleshenca është adoleshencë, pavarësisht nëse ke apo nuk ke aftësi të kufizuara dhe këtë duhet ta pranojmë të gjithë. Ndodhemi pikërisht në vitet e shpërthimeve emocionale. Prindërit dhe të rinjtë sikur e ndjejnë veten jo të qetë me njëri-tjetrin. Diku grindje, më tej një qarje e pa justifikuar, rebelim, pak "furtunë", hutim, c'po ndodh?! Të dhënat e studimeve tregojnë se në fund të fundit cilat do qofshin konfliktet në këtë moshë, të rinjtë i duan prindërit e tyre dhe ndjehen më të sigurtë kur i kanë ata në anën e tyre. Atëhere, pse shumë njerëz e bëjnë adoleshencën të vështirë?!

Është koha e ndryshimeve të shpejta fizike dhe emocionale. Kjo mund të jetë sa e këndshme aq edhe coroditëse e shqetësuese

për fëmijën dhe prindërit. Ndryshimet e vullshme nisin gradualisht, rreth moshë 11-vjec për vajzat dhe 13-vjec për djemtë. Ndryshimet hormonale që ndodhin në trupin e tyre mund tu krijojnë gjendje shqetësuese më pak a më shumë të dukshme. Vajzat i nisin këto ndryshime më herët se djemtë dhe për 3-4 vitet e para duket se piqen më shpejt. Më pas djemtë i arrijnë ato. Rreth moshë 17 vjec ata janë djem dhe vajza të reja që mund të konsiderohen po aq të mëdhenj sa edhe prindërit e tyre, të aftë të kenë dhe ata tashmë fëmijët e tyre. Periudha kur vajza arrin të jetë në gjendje të ngelet shtatzanë, të riprodhojë, mund të koincidojë me moshën kur nëna mund ta humbasë këtë aftësi duke kaluar në menopauzë dhe kjo e komplikon disi problemin.

Nuk është për tu cuditur që në vorbullën e këtyre ndryshimeve të shpejta që ndodhin disa adoleshentë shprehin një preokupim më të madh për paraqitjen e tyre. Ata e kërkojnë me insistim këtë, dhe duan të bindin veten se po rriten

dhe po maturohen po aq shpejt sa edhe bashkëmoshatarët e tyre që nuk paraqesin A.K. Ata dhe prindërit e tyre do të shqetësoheshin më pak nëse do të ishin të ndërgjegjshëm se është normale që periodat e para tek vajzat, apo ndryshimi i zërit tek djemtë, si edhe të gjitha ndryshimet e tjera nuk ndodhin tek të gjithë njëloj.

E gjithë kjo rritje dhe zhvillim kërkon shumë energji dhe kjo mund të shpjegojë faktin pse adoleshentët shpesh duken sikur kanë nevojë për më shumë gjumë. Zgjimi vonë në mëngjes mund të irritojë prindërit, por shumë mirë kjo mund të mos jetë thjesht një plogështi apo dembelizëm. Në një kohë me rritjen në shtat, përdorimin e briskut nga djemtë për tu rruajtur, apo me nisjen e periodave tek vajzat, të rinjtë e kësaj moshe fillojnë të mendojnë dhe ndjejnë ndryshe. Ata zgjerojnë marrëdhëniet jashtë familjes me miq e shokë të moshës së tyre. Njëkohësisht, edhe marrëdhëniet brenda familjes marrin tjetër karakter. Prindërit bëhen më pak të rëndësishëm në sytë e të

rinjve, ndërkohë intersimi i tyre për jetën jashtë familjes shtohet.

Shpesh prindërit ndjehen si të mënjanuar, të përjashtuar dhe në një farë mënyrë kështu ndodh në të vërtetë. Ky është një realitet që nuk mund të mohohet. Ky përjashtim apo mospranim i tyre është i nevojshëm që të rinjtë të rriten, të formojnë identitetin e tyre. Sherret dhe grindjet mund të jenë të shpeshta, por në shumicën e rasteve çfarë do që të ndodhë, ende në mendjen e adoleshentit prindi zë një vend të vecantë dhe dinjitoz. Kundërshtimet apo konfliktet shpesh nuk kanë të bëjnë me personalitetin e prindit, por thjesht me faktin se ata janë prindër, nga të cilët fëmijët kërkojnë të bëhen gjithmonë e më të pavarur.

Në përpjekjet për të rritur pavarësinë, duke provuar situata të reja, jo rrallë herë ata e kuptojnë se u mungon përvoja, duke përjetuar edhe gjendje dështimi apo stresi. Kjo justifikon deri diku ndryshimet shpejta në sjelljet e tyre dhe mendimet që kanë për veten. Brenda një minute i duket vetja kur shumë i rritur, kur shumë fëmijor, duke i manifestuar këto në familje apo në shoqëri. Në këto situata prindërit duhet të jenë shumë fleksibël, pavarësisht nëse edhe vet mund të ndodhen në një gjendje të vështirë.

Pa u zgjatur në problemet emocionale me të cilat ballafaqohet kjo moshë si qarjet apo largimet nga shtëpia, theksojmë se këto vështirësi të adoleshencës nuk janë serioze dhe nuk vazhdojnë shumë gjatë. Ato janë vështirësi të rritjes dhe zhvillimit të tyre. Prindërit mund ta ndjejnë veten sikur kanë dështuar, por çfarë do që të ndodhë, çfarë do që të thuhet në një moment “të nxehtë”, prindërit akoma luanë një rol të madh në jetën e fëmijëve të tyre dhe

sidomos tek të rinjtë që paraqesin A.K. Prindërit nuk duhet të kërkojnë që fëmijët e tyre të cilët tashmë nuk janë as fëmijë as të rritur, të jenë të kënaqur. Ata mund të mos jenë kështu përderisa të kenë fëmijët e tyre, shtëpinë e tyre, jetën e tyre, ashtu sic e endërrojnë dhe për këtë s’ka përse të bëhemi xheloz, është e drejta e tyre.

Zakonisht, megjithëse pranohet se cdo fazë e jetës ka problemet e veta, shumica e studiuesve janë dakord dhe pranojnë se adoleshencia përbën një periudhë të vështirë si për adoleshentin ashtu edhe për familjen dhe shoqërinë në tërësi. Arsyet mund të jenë të ndryshme dhe specifike për secilin rast. Përmendim më poshtë disa prej tyre:

- **Mungesë ekuilibri, apo c’ballancime të ndryshme që ndodhin midis zhvillimit fizik dhe atij mendor, pjekuri shoqërore, vonesë në shfaqjen e shprehive të nevojshme për të vendosur marrëdhënie seksuale;**
- **Përplasje midis autoriteteve: prind që “me zor lëshon pe” dhe adoleshent i cili po formohet dhe po krijon autoritetin e tij. Nga një anë e tërheqim shokët, në anën tjetër veprojnë prindërit. Në këtë situatë prindi ndjen se po humbet vendin qendror në dashurinë e fëmijës;**
- **Status i dyshimtë i adoleshentit: as fëmijë, as i rritur, sidomos kur të tjerët e trajtojnë si të vogël dhe ai do të luaj rolin e të rriturit, ose e kundërta, kur i kërkohet të sillet si i rritur në një kohë kur ende aftësitë e tij janë fëmijore.**

Në vështrimin psiko-shoqëror adoleshencia është një fazë tranzicioni, kur njeriu kalon

nga statusi i fëmijërisë në atë të të rriturit, më saktë nga gjendja e varësisë në atë të pavarësisë. Sic shihet hapi është tepër i madh dhe për këtë fëmija bën hap përgatitore qysh herët, që në momentin që ai zgjedh çfarë të haj dhe kur të haj, c’rroba të vesh, kur të lahet e ku të rrijë etj. Nga kjo pikëpamje, adoleshencia nuk është gjë tjetër vecse një etapë më e avancuar në këtë zhvillim progresiv, kur kërkesat, interesat, nevojat e reja të individit kërkojnë një menaxhim më të mirë, kur më shumë se kurdoherë ai do të bëhet protagonist i vetvetes. Në këtë proces të rritjes gjatë adoleshencës ata bëhen gjithnjë e më të ndryshëm, formojnë stilin e tyre, fitojnë cilësi që do u duhen për të përballuar jetën.

Sigurisht, rruga për tu bërë i pavarur nuk është i lehtë. Mjaft persona, për arsye të ndryshe nuk arrijnë pjekurinë e nevojshme për tu bërë të pavarur. Në disa raste kur ndodhemi para të rinjve që paraqesin aftësi të kufizuara disi më të rënda të sferës mendore ndodh që individit nuk arrin të fitojë ndërgjegjësimin e nevojshëm për realitetin ku jeton. Nga ana tjetër, po të mos ofrohen mundësi të shumta për të mësuar dhe ushtruar shprehitë që i duhen, vetkuptohet që sjelljet e tij do të jenë tepër problematike. Në këtë kontekst, jo rrallë herë mbështeten mendimet dhe qëndrimet e gabura të familjarëve dhe shoqërisë. Kështu, për shembull, për prapmbetjen e niveleve të rënda, tradicionalisht është menduar se ata janë të paaftë të vendosin vetë, qoftë edhe për gjëra të thjeshta. Prindërit dhe kujdestarët shpesh veprojnë dhe vendosin ata për këta të rinj, duke i menduar këta individë si: pjesërisht fëmijë, aseksual, qenie passive, duke injoruar mundësitë e mëdha që ata disponojnë.

Fakte të shumta sot dëshmojnë se edhe nivelet e rënda të personave me aftësi të kufizuara, arrijnë të bëhen të pavarur, të kenë jetën e tyre, të punësohen në procese të thjeshta, të krijojnë edhe familje. Në qoftëse ata stimulohen dhe ushtrohen gradualisht gjatë jetës, pa i paragjykuar dhe pa neglizhuar as një fazë, këta të rinj edhe sepse me pak ndihmë arrijnë në pavarësi të mjaftueshme, në gjendje për të kryer me përgjegjësi veprime dhe marrëdhënie që kërkon adoleshenca dhe më pas moshën e të rriturit.

Ajo që i mundon prindërit është më shumë frika ndaj rreziqeve, kjo si edhe mendimi i tyre se kjo situatë nuk është kalimtare, i bën këta prindër që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në moshën e adoleshencës, ti tejmbrojnë fëmijët e tyre duke kontrolluar çdo detaj të sjelljes së tyre duke u përballuar papritur me situata tepër të vështira si manifestime seksuale të ekzagjeruara etj., gjë që nuk ndodh në ato familje ku vazhdimisht bëhet kujdes dhe ka preokupim për të rritur gradualisht pavarësinë e të rinjve adoleshentë.

Duke mos i dhënë fëmijës oportunitete që të zhvillojë pavarësinë, prindi e mban atë artificialisht në një gjendje fëminore dhe mbas ca kohe zgjohet dhe kupton se fëmija ka kaluar nga "i vogël" direkt "në plakje", duke i privuar atij periudhën më të bukur të jetës.

Sigurisht, zgjidhje të parafabrikuara dhe cudibërëse për çdo rast nuk ka. Cdo familje duhet të përpiqet të gjej zgjidhje racionale që pajtojnë dhe balancojnë të drejtën e personit me aftësi të kufizuara për të rritur pavarësinë e tij sa më shumë të jetë e mundur duke ushtruar atë konkretisht në atë me përgjegjësi në atë shkallë që shoqëria e kërkon për çdo individ. ■

Qendra për Zhvillimin e Shanseve të Barabarta

Qendra për Zhvillimin e Shanseve të Barabarta do të zhvillojë aktivitetin e saj në qytetin e Shkodrës, si programi me i ri i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK).



Selia e FSHDPAK është në Tiranë dhe që nga Janari i vitit 2006, FSHDPAK ka zyrat e veta dhe operon dhe në Shkodër.

Fusha e veprimatrise së qendres së FSHDPAK në Shkodër?

Aktiviteti i Qendres për Zhvillimin e Shanseve të Barabarta, Shkodër është i fokusuar në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara mendore dhe familjareve të tyre. Kjo qendër përben një nga modelet që promovon të drejtat dhe pjesëmarrjen e njerezve me AK në jetën e shoqërisë shqiptare përmes arsimit, punësimit, formimit profesional, jetës aktive në komunitet.

Qendra do të shërbejë si qendër burimore informacioni, trainimi, orientimi, mbrojtje ligjore për

personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.

Qendra ofron për personat e interesuar:

1- Informacion në fushën e aftësive të kufizuara, në mënyrë të veçantë në fushën e aftësive të kufizuara mendore, në lidhje me të drejtat, legjislacionin, shërbimet sociale në këto fushë, arsim, punësim, etj,

2- Trajnime për prindër, familjare, ofrues të shërbimeve, specialiste në fushën e arsimit dhe punësimit, pushtetit lokal dhe institucioneve përgjegjëse publike dhe private për problematiken e aftësive të kufizuara mendore

3- Mbrojtje ligjore dhe avokat falas për individë me aftësi të kufizuara dhe familjare të tyre.

Mbrojtje ligjore kur personit me aftesi te kufizuar i shkelen te drejtat per arsim, per pune apo ne vendin e punes, te drejtat ne institucionet e sherbimeve sociale publike apo private.

4- Informacion, lobim dhe avokati, dhe ndermjetesim per arsimimin ne shkollat publike per personat me aftesi te kufizuara.

- Ndermjetesim me Drejtorine arsimore dhe shkollat e arsimit publik per realizimin e arsimit gjithepershires per PAK mendore

5- Informacion, lobim dhe avokati, orientim dhe ndermjetesim per punesim te personave me aftesi te kufizuar

- Ndermjetesim me Zyrat e punes ne bashki dhe komune per realizimin e trajnimit profesional dhe punesimit te PAK mendore
- Ndermjetesim me nderrmarjet shteterore dhe private

6- Informacion, orientim dhe organizim i pjesmarrjes se



aftesi te kufizuar si dhe mbeshtetje e rrjetit ne fushatat per lobim dhe avokati per te drejtat e femijeve te tyre.

Kush jane perfituesit e Sherbimeve te Qendres

- Individe me aftesi te kufizuara mendore dhe familjare te tyre
- Organizata dhe rrjete te prinderve te njerezve me aftesi

komunave) dhe drejtorite perkatese per problematikat e sherbimeve sociale, arsimit, punesimit etj

- Ofruesit e sherbimeve publike dhe private per personat me aftesi te kufizuara mendore
- Aktore te tjere te shoqerise civile, si media, organizata te tjera lokale , kombetare dhe nderkombetare qe operojne ne qytetin e Shkodres ne fushen e te drejtave, femijeve, grave, etj.
- Komuniteti i biznesit



individëve me AK mendore ne aktivitete te ndryshme social kulturore te organizuara ne komunitet.

7- Mbeshtetje per krijimin e nje rrjeti te prinderve te femijeve me

te kufizuara mendore

- Struktura shteterore pergjegjese per problematiken e aftesise se kufizuar ne nivel lokal(Keshilli i qarkut, Prefektura, Bashkia, Keshilli bashkiak, Komuna, Keshilla te

Stafi i Qendres

Prane qendres jane te punesuar 4 vete, profesioniste te fushes, familjare dhe jurist.

Nje ekip ekspertesh dhe trajneresh te specializuar ne fushen e AK , do te mundesojne realizimin me sukses te programit.

Kontaktوني me Qendren

Qendra per Zhvillimin e Shanseve te Barabarta, ofron sherbimet e saj çdo dite, nga e hena ne te premte, nga ora 9.00-17.00 ne ambjentet e saj ne adresen: Lagja " Vasil Shanto", Rr: " Ndre Mjeda", nr.11, Shkoder.

Tel: ++355 (022) 50653

Personat me Aftësi të Kufizuar, jashtë tregut të punës, barrë e familjes

Diskriminimi i këtyre personave nga pjesa tjetër e shoqërisë, kërkon ndërhyrjen e shoqërisë civile për të nxitur shtetin në hartimin e politikave dhe zbatimin e duhur

Janë bërë disa ndryshime, por sërisht ata mbeten të diskriminuar nga pjesa tjetër e shoqërisë në shumë drejtime. Ata vazhdojnë t'i bëhen barrë familjes dhe të qëndrojnë jashtë tregut të punës. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët nuk janë të pakët por përbëjnë 10% të popullsisë, vazhdojnë të jetojnë në varfëri, megjithëse premtimet janë bërë të shumta për ta, si nga Qeveria e mëparshme, ashtu dhe sot. Fëmijët me aftësi të kufizuar nuk e kanë aksesin e duhur për të ndjekur shkollat. Sipas Zela Kokes-Koodinatore e shoqatës MEDPAK, faktorët që ndikojnë për të mos patur vëmendjen e duhur nga këto institucione janë të shumtë. Në një intervistë për revistën "SFIDA", ajo rendit disa pika, të cilat kanë dalë gjatë takimeve që ka organizuar kjo shoqatë. Ndërkohë që Bardhylka Kospiri, Koordinator e programit të avokatisë të Fondacionit Shqiptar për Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK), bën të ditur se problemi i personave me aftësi të kufizuar ka zënë një vend më të gjërë në politikat qeveritare dhe ndërgjegjësimi është në rritje, por që ka akoma shumë për t'u bërë. Në intervistën e dhënë për "SFIDEN", Bardhylka shpjegon problemet që vazhdojnë të kete kjo shtresë e popullsisë dhe çfarë është arritur të bëhet deri sot. Ndërkohë që për Presidentin e Invalidëve të Punës së Shqipërisë Abdulla Omuri, në shumicën e rasteve argumentimi i problema-tikave të personave me

aftësi të kufizuara trajtohet në institucionet përgjegjëse, nga ana e shoqatave apo organizatave të ndryshme që merren me problemet e AK, këto shqetësime bien në veshë të shurdher. Sipas tij shqetësimet me

Zbatimi i legjislacionit në Shqipëri për AK dhe partneriteti i shoqërisë civile që trajton problemet e AK me shtetin, do të përmirësonin dukshëm problemet e PAK në vend

të mëdha ju vijnë personave me aftësi të kufizuara nga mos zbatimi i ligjit.

Bardhylka Kospiri – Koordinator e programit të avokatisë FSHDPAK

Roli i shoqërisë civile shpesh është vendimtar në zgjidhjen e problemeve shoqërore, Ç'mund të thuhet në fushën e aftësisë së kufizuar ?

Personat me aftësi të kufizuar janë pjesë e shoqërisë. Duke iu referuar shifrave zyrtare ata përbejnë rreth 10% të popullsisë dhe kjo është një shifër në rritje. Kjo pjesë e shoqërisë përjeton çdo ditë diskriminimin dhe veçimin, për rrjedhojë jeton në kushte varfërie të tejshkajshme. Kështu që zgjidhja e

problemeve për këtë grupim duhet të jetë në qendër të politikave qeveritare. Pikërisht se shpesh këto politika janë të pamjaftueshme dhe nuk ofrojnë zgjidhjet e duhura, është e domosdoshme ndërhyrja e shoqërisë civile për të nxitur dhe monitoruar shtetin në hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre. Nuk janë të pakta rastet kur edhe nismat për ndryshime kanë ardhur pikërisht nga organizata joqeritare në fushën e aftësisë së kufizuar. Si një nga më të rendësishmet do të veçoja nismën e FSHDPAK për grupimin e shoqatave të aftësisë së kufizuar, me qëllim nxitjen e qeverisë për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, si edhe për përmirësime të tjera ligjore që ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetës për PAK. Sigurisht që arritja e rezultateve varet nga shumë faktorë. Është shumë e rendësishme të kuptohet që rezultatet janë më të plota, të qëndrueshme dhe afat-gjatë nëse për zgjidhjen e problemeve të aftësisë së kufizuar ndërtohen rrjete bashkëpunimi ku përfshihen jo vetëm ata që e përjetojnë atë direkt, por një rreth më i gjerë shoqëror që e kupton drejt problematikën, ka kapacite, vizion dhe ide të qarta për zgjidhjet e duhura dhe bashkëpunon në mënyrë konstruktive.

Në institucionet përgjegjëse për problematikën e AK a gjeni vëmendjen e duhur për problemet që paraqiten?

Tashmë problematika e aftësisë së kufizuar ka zenë vend më gjerësisht në politikat qeveritare dhe niveli i ndërgjegjësimit është në rritje. Megjithatë përderisa për fëmijët me aftësi të kufizuar nuk krijohet akses i duhur për të ndjekur shkollat, përderisa personat me aftësi të kufizuar mbeten të mbyllur dhe të izoluar për shkak të barrierave mjedisore, institucionale dhe të qendrimit, përderisa personat me aftësi të kufizuar janë jashtë tregut të punës dhe shpesh mbeten barrë e familjeve të tyre, do të thotë që ende nuk është tërhequr vëmendja e duhur e institucioneve përgjegjëse.

Arritjet e ndryshme në legjislacionin shqiptar për AK dhe zbatimin e tij a kanë sjellë përmirësim real të jetës së PAK?

Nuk do të thoja se s'ka arritje. Ndryshimet ligjore kanë bërë që grupime të ndryshme të aftësisë së kufizuar, si rezultat i përpjekjeve të veçanta, të arrijnë në rezultate konkrete dhe janë përfitues të skemave të ndryshme. Por ata janë në numër të kufizuar dhe mbeten përfitues pasivë duke qenë shumë larg gjithpërfshirjes në jetën shoqërore mbi bazën e shanseve të barabarta. Për më tepër ka grupime të veçanta të aftësisë së kufizuar, siç janë personat me aftësi të kufizuar mendore, që nuk kanë mbështetjen e duhur ligjore dhe jetojnë përtej kufirit të varfërisë. Gjithashtu mos shoqërimi i ligjit, edhe pse i përmirësuar, me akte nën ligjore dhe me sanksionet përkatëse, e bën atë të pazbatueshëm, për rrjedhojë nuk arrin të ketë asnjë rezultat të dukshëm në jetën e PAK

Zela Koka- Koodinatore e shoqatës MEDPAK (Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar.)

Roli i shoqërisë civile shpesh është vendimtar në zgjidhjen e

problemeve të ndryshme të shoqërisë. Ç'mund të thuhet në fushën e aftësisë së kufizuar?

Ju e thatë dhe vetë që roli i shoqërisë është vendimtar në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë. Une do të shtoja se është vendimtar edhe për zhvillimin e demokracisë së një shoqërisë . Kjo ka ndikuar edhe në fushën e aftësisë së kufizuar. Ngritja dhe fuqizimi i shoqatave të prindërve, të fëmijëve me aftësi të kufizuar, ka bërë që të ndryshojnë disa gjëra në favor të realizimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe në radhë të parë ndryshimi i vetë mentalitetit të prindërve për të pranuar realitetin dhe për të luftuar vete për barazime e të drejtave me fëmijet e tjere në komunitetin ku jetojnë.

Do të pohoja se MEDPAK ka një sërë arritjesh për realizimin e të drejtës për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Rreth 60% e fëmijëve me aftësi të kufizuar në rrethin e Librazhdit janë integruar në shkollat pranë vendbanimit të tyre. Kjo ka bërë që në dy shkollat e qytetit të jemi në hapat e para të krijimit të elementeve për një shkolle gjithpërfshirëse.

Në institucionet përgjegjëse për problematikën e aftësisë së kufizuar , a gjeni vëmendjen e duhur për problemet që paraqiten?

Në institucionet përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të personave me AK nuk mund të themi që gjithmonë kanë vëmendjen e duhur, por jo vetëm në institucione të tilla. Ne nuk e shikojmë të ndarë jetën në institucione për AK dhe në institucione për të tjerë. Në qoftëse ndalemi në pushtetin vendor. Megjithatë legjislacioni shqiptar e ngarkon me një sërë detyrimesh, ai për personat me aftësi të kufizuar bën vetëm pagesën (6800 lekë) dhe vetëm për një numër shumë të kufizuar personash jep edhe shërbime të

tjera. Psh asnjë komunë apo bashki në nëprefekturën e Librazhdit nuk ka në programet e veta dhënie shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar. Shërbimi rajonal apo edhe ai shtetëror e konsiderojnë punë të tyre vetëm mbledhjen e të dhënave nga institucionet lokale apo projektet të ndryshme . Ata me shumë përpikmëri shikojnë vetëm plotësimin e dosjes me dokumentacionin përkatës dhe vetëm kaq. Faktorët që ndikojnë për të mos patur vëmendjen e duhur nga këto institucione janë të shumtë. Unë dëshiroj të përmënd disa, ato që kanë dalë shpesh herë edhe në tavolina pune që janë organizuar nga MEDPAK I . Mungesa e një kulture për ta parë aftësinë e kufizuar jo më si një problem vetëm të personit por si një problem të shoqërisë .Dua të shtoj ketu se mbetet shumë për të bërë për ta parë atë në një këndvështrim social dhe jo vetëm mjeksor. 2. Mungesa e zbatimit të legjislacionit dhe vendimeve të qeverisë nga struktura të veçanta. 3.Mungesa e informacionit që duhet të kenë personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre në lidhje me përfitimet që ata mund të kenë nga legjislacioni shqiptar. 4.Megjithatë ka një strategji të miratuar nga qeveria shqiptare akoma ajo nuk njihet nga pushteti lokal dhe jo me të gjej zbatim. 5.Mungesa e fondeve për fushën e shërbimeve dhe decentralizimi i tyre

Arritjet e ndryshme në legjislacionin shqiptar për aftësinë e kufizuar dhe zbatimin e tij a kanë sjellë përmirësimin real të jetës së personave me aftësi të kufizuar?

Në qoftëse krahasojme legjislacionin shqiptar në fushën e aftësisë së kufizuar mund të themi që është një legjislacion i vëndeve të përparuara si në fushën e shërbimeve, arsimit dhe punësimit. Përmirësimet kanë sjellë, por këto përmirësimet janë për një numër

shumë të kufizuar njerëzish. P.sh në qoftëse flasim për shërbimet mund të themi që ato ekzistojnë vetëm për një numër të vogël PAK në qytete të mëdha shumica falë projekteve të shoqatave por jo si një zbatim i legjislacionit shqiptar.

Abdulla Omuri –President i Shoqatës së Invalidëve të Punës së Shqipërisë

Roli i shoqërisë civile shpesh është vendimtar në zgjidhjen e problemeve të ndryshme të shoqërisë. Ç'mund të thuhet në fushën e aftësisë së kufizuar?

Në një shtet demokratik roli i shoqërisë civile është i domosdoshëm dhe në shumicën e rasteve është vendimtare në problematikat që shqetesojnë komunitetin. Shoqëria civile në vetvete duhet të jetë e orientuar dhe pozicionuar drejt në nismat dhe objektivat që i shërbejnë shtresave të caktuara të shoqërisë. Si në çdo vend tjetër edhe në Shqipëri funksionojnë një sërë OJF që operojnë në fushën e aftësisë së kufizuar.

Ato tani janë të organizuara dhe funksionojnë në bazë të një legjislacioni të miratuar nga Parlamenti Shqiptar. Është fakt se roli i shoqërisë civile në fushën e aftësisë së kufizuar ka qenë vendimtar në përmirësimin e kushteve ekonomiko-sociale të kësaj shtrese. Një rol të madh dhe të rëndësishëm këto organizata kanë luajtur në lidhje me trajtimin ligjor që iu është bërë disa kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar; si p.sh. invalideve të luftës, invalideve të punës, invalideve të verber, invalideve para dhe tetraplegjike e tjere. Është meritë e këtyre shoqatave që me argumentat që ato paraqiten para institucioneve shtetërore, ekzekutive dhe legjislative bënë të mundur përfshirjen e AK edhe në ligjin themelor të shtetit. Ishin po këto shoqata që me iniciativën e Fondacionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

punuan sëbashku për hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare të PAK(Personave me Aftësi të Kufizuara), si dhe një sërë projektesh të tjera ligjore dhe nënligjore, ku mendimi, veprimi dhe aftësia e këtyre OJF ka përmirësuar në maksimum nga ana ligjore gjendjen e këtyre shtresave.

Në institucionet përgjegjëse për problematikën e aftësisë së kufizuar, a gjeni vëmendjen e duhur për problemet që paraqesni? Çfarë faktorësh ndikojnë?

Për të qenë sa më realist, në ato që unë thashë më sipër, përmenda kontributin e shoqërisë civile për përsosjen e një legjislacioni bashkëkohor për ato kategori që mbulohen deri tani me këtë legjislacion, por ky kontribut është edhe i institucioneve shtetërore që në bashkëpunim me OJF kanë bërë të mundur suksesin e arritur. Problematikat e AK janë të shumta që lidhen direkt me efekte financiare.

Kuptohet një vend si Shqipëria që akoma është një vend në tranzicion, efektet e këtij tranzicioni i ndiejnë më shumë shtresat e AK. Duhet kuptuar nga cilido se personave me aftësi të kufizuara iu mungojnë dy gjërat më kryesore në jetë: - shëndeti dhe ekonomia.

Në shumicën e rasteve argumentimi i problematikave të personave me aftësi të kufizuara trajtohet në institucionet përgjegjëse, nga ana e shoqatave apo organizatave të ndryshme që merren me problemet e AK, këto shqetësime bien në veshë të shurdher.

Duhet të dimë se shqetësimet me të mëdha ju vijnë personave me aftësi të kufizuara nga mos zbatimi i ligjit. Mos zbatimi i ligjit është mungesë serioziteti dhe mungesë vullneti e institucioneve përgjegjëse për këtë qëllim. Siç e thekosva dhe më lart është bërë i mundur hartimi i një legjislacioni të përafert me sandartet ndërkombëtare.

Jemi të ndergjegjshëm se nuk mund të pretendojmë që ne personat me AK të trajtohem si kolegët tanë në vendet perendimore, por është e pafalshme që të mos jemi të barabartë me personat me AK të disa vendeve fqinje që kanë një potencial shtetëror më të ulët se vendi ynë dhe problemet në trajtimin e AK i kanë disa herë më të mira se ne.

Arritjet në legjislacionin shqiptar për AK janë të dukshme dhe meritë në këtë drejtim kanë të gjitha OJF që me një menyrë apo me një tjetër kanë kontribuar në përsosjen e këtij legjislacioni.

Arritjet e ndryshme në legjislacionin shqiptar për aftësinë e kufizuar dhe zbatimin e tij a kanë sjellë përmirësimin real të jetës së personave me aftësi të kufizuar?

Që një ligj të jetë funksional dhe i zbatueshëm në praktikë, normalisht duhet të plotësohet edhe me akte nënligjore, siç janë VKM-të dhe udhëzimet e dikasterit përkatës. Në këtë drejtim ka mjaft boshllëk.

Dua të përmend se në këto ligje janë parashikuar mjaft lehtësi sociale për AK, si përjashtimi nga taksat nacionale dhe lokale, rrugëtimi në mjetet e komunikacionit urban dhe interurban, punësimi në çdo 25 punonjës punëdhënësi është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuar, lehtësi në arsimin e lartë, përfitimin e ilaçeve falas dhe me 50% të çmimit. Pra i gjithë legjislacioni ka nënë të ndryshme me karakter social. Zbatimi i këtij legjislacioni do të përmirësonte edhe 25% jetën e personave me aftësi të kufizuara. Kam bindjen se zbatimi i legjislacionit në Shqipëri për AK dhe partneriteti i shoqërisë civile që trajton problemet e AK me shtetin; përmirësojnë në maksimum problemet e AK në vend.

Manjola Zeka
gazetare, Gazeta "Koha Jone"

Sfidoje veten dhe ndryshoje botën

Ishte kjo motoja e takimit të tretë të Institutit Ndërkombëtar të grave në Leadership (Udhëheqje) në aftësinë e kufizuar, i organizuar nga Mobility International USA (MIUSA), i cili u mbajt nga 9-26 Gusht 2006 në Eugene, shteti Oregon, USA, me pjesëmarrjen e 30 delegateve nga 30 vende të botës. Unë isha e vetme përfaqësuese nga Shqipëria. Pjesëmarrja dhe aktivizimi im në trajnimin e organizuar nga FSHDPAK, që u zhvillua në Tiranë në maj të këtij viti me përfaqësuesen e MIUSA-s, si edhe mbështetja e mëtejshme e FSHDPAK bënë të mundur që unë të isha fituese dhe përfituese e aplikimit për këtë aktivitet.

Të gjitha pjesëmarrëset ishin gra që u përkisnin fushave të ndryshme të AK, të cilat jepnin kontributin e tyre duke punuar në fondacione e shoqata për PAK në vendet e tyre.

Takimi filloi me njohjen dhe prezantimin e të gjitha pjesëmarrëseve me stafin e MIUSA-s dhe më pas një darkë mirëseardhjeje nga familjet pritëse dhe kryetarja e bashkisë së qytetit Eugene. Ishe një pritje shumë e ngrohtë dhe e përzemërt. Ditët e tjera pasuan me një program shumë të ngjeshur dhe interesant.

Pjesën më të madhe të programeve e zinin workshopet të cilat bazoheshin në trajnimin e



gjithë pjesëmarrëseve për përfitimin e një eksperience sa më të kualifikuar në Leadership (Udhëheqje) në fushën a AK. Trajnimi i parë kishte të bënte me Politikën dhe Legjislacionin për fushën a AK. Këtu u sollën shumë shembuj nga delegatet nëse kishte një legjislacion përkatës për PAK në vendet e tyre dhe nëse ky legjislacion gjente zbatim në jetën e përditshme dhe se çfarë përfitonin PAK nga këto ligje.

Një workshop tjetër me interes ishte ai i planifikimit të një projekti dhe propozimi me shkrim për mbledhjen e fondeve. Secilës pjesëmarrëse iu kërkua të hartonte një projekt duke patur parasysh kushtet e rrethanat e vendit nga vinte dhe të projektonte dicka konkrete në atë që çfarë mund të bënte ajo në përmirësimin e një treguesi në jetën e një personi me AK. Projekti im ishte: Dhënia e

mundësisë së zhvillimit të bizneseve të vogla për punësimin e PAK duke bashkëvepruar ngushtë me organet e qeverisjes lokale. Më pas hartimi i propozimeve me shkrim për mbledhjen e fondeve për të realizuar projektin tënd ishte një temë që ngjalli shumë interes, sepse projektet mund të jenë shumë interesante dhe të dobishme, por thjesht mosnjohja e mënyrës së mbledhjes së fondeve, apo mënyra e gabuar e bërjes së një propozimi çon në dështimin e këtij projekti.

Këshilla ishte që gjithmonë mendoni për projekte që janë të realizueshme dhe jo projekte “ëndrra” që thjeshtë mbesin në letra e nuk zbatohen. Filloni me ndryshime të vogla për të arritur te ato të mëdhatë. Jini të ndershëm me atë çfarë thoni se do të bëni, diçka të vogël, reale, të dobishme dhe në këtë mënyrë ju do të gjeni përkrahjen. Asnjë i vetëm nuk mund ta ndryshojë botën.

Një tjetër workshop interesant ishte ai i medias. Bashkëveprimi me Median është një pikë kyçe në realizimin e një projekti. Media duhet të jetë një aleat i ngushtë për ne. T’i përdorim mediat për t’i informuar njerëzit dhe opinionin e gjerë publik për barrierat e vërteta që pengojnë pjesmarrjen tonë të plotë në të gjitha fushat e jetës dhe çfarë po bëjmë ne që t’i kapërcejmë ato. Këtu, madje u soll një shembull se çfarë kishin bërë disa PAK, përdorues të karrigeve me rrota në një qytet të Rumanisë. Pas shume negociatave jo të suksesshme me Kryetarin e Bashkisë së qytetit për ta bërë bulevardin kryesor të qytetit të

përshtatshëm për kushtet e tyre, ata e kishin detyruar atë të ulej në karrige me rrota, në prani të MEDIA-s dhe të bënte një “shëtitje” në bulevardin e papërshtatur. Vështirësitë që ai ndeshi e bënë të kuptojë që duhet të bënte patjetër diçka për këta njerëz. Sot në këtë qytet të Rumanisë bulevardi kryesor është

Unë isha e vetme përfaqësuese nga Shqipëria. Pjesëmarrja dhe aktivizimi im në trajnimin e organizuar nga FSHDPAK, që u zhvillua në Tiranë në maj të këtij viti me përfaqësuesen e MIUSA-s, si edhe mbështetja e mëtejshme e FSHDPAK bënë të mundur që unë të isha fituese dhe përfituese e aplikimit për këtë aktivitet.

i mbushur plot me njerëz që shëtisin me karriget e tyre me rrota në të.

Gjithashtu një vend dominues iu kushtua temave të tilla si: “Të jesh prind me aftësi të kufizuar”, “Ndalimi i dhunës në familje për PAK”, “Vetë-Mbrojtja kundrejt një sulmi të mundshëm”, “Informimi dhe Mbrojtja kundër sëmundjeve infektive si AIDS” etj. Përveç trajnimit që bëmë me temat e mësipërme, vlejën për t’u theksuar dhe një sërë takimesh që kemi bërë me përfaqësues të fondacioneve të ndryshme ndërkombëtare për zhvillim (International Development Foundation), disa prej të cilëve veprojnë dhe në

Shqipëri. Ndër ta ishin: Kavita Ramdas, Presidentja e Fondacionit Global për Gratë (që së shpejti do të vizitojë Shqipërinë për herë të parë), Trickle Up (Mbështetëse e bizneseve të vogla), USAID, Hesperian Foundation, AWID (The Association for the women’s rights in Development) etj.

Trajnimi teorik u kombinua me atë praktik. Bërja e një sërë aktiviteteve sportive si: ngjitja me litarë, lundrimi në lum, kampingu në mal, noti në pishina ishin një sfidë e vërtetë për të gjithë ne. Tani dua të them dy fjalë për qytetin e Eugene dhe njerëzit e mrekullueshëm të tij. Ishte qyteti që na ofroi përshtatshmërinë gjatë gjithë kohës: me një infrastrukturë të moderuar që nga trotualet dhe rrugët e përshtatshme për përdoruesit e karrigeve me rrota, sinjalet akustike për të verbrit dhe të gjithë autobuzët e qytetit që ishin të përshtatshëm dhe komod për PAK.

Në fund dua të falenderoj tridhjetë familjet amerikane që hapën dyert dhe zemrat e tyre duke na dhënë një familje të vërtetë, duke na ndjekur në të gjitha veprimtaritë tona dhe duke na njohur me pjesë të jetës dhe kulturës amerikane. “LOUD, PROUD, PASSIONATE” ishte kjo thirrja mbyllëse e gjithë trajnimit që do të thotë: “FORT, ME KRENARI DHE PASION” të luftojmë për të drejtat tona sepse kemi të drejtë ta jetojmë jetën ashtu si çdo njeri tjetër.

Teuta Halili,
*person me aftësi të kufizuar,
përdoruese e karrikes me
rrota*

SI TË GATUAJMË

I. MELÇI QENGJI ME KOS E HUDHRA

Normativa për 5 persona:

Melçi qengji	500 gr,
Vaj	100 gr,
Hudhra	2 kokra,
Vere e kuqe	1 filxhan kafeje,
Kos	1 kg,
pak kripë, piper , rigon e majdanos.	

Përgatitja :

Melçite e prera në feta të holla i fergojme në tigan me yndyrë, i shuajmë me vere, i hedhim në një tenxhere ku shtojmë kripë, piper , majdanos të grire holle, i mbulojme me kapak dhe i lëmë në anë të sobes (në ambient të ngrohte) shtypim me pak kripë hudhrat dhe i për zejme me kos.

Shërbehen melçite duke i hedhur sipër kosin e për gatitur me hudhra.

MESNIK

Normativa për 5 persona :

Miell	500 gr
Niseshte	100 gr
Gjalp	200 gr
Qumësht	½ litër
vezë	4 kokra
Mish	500 gr
Kripë e piper	

Përgatitja : Zëmë brumin si për byrek duke shtuar 1 vezë, 1 gotë Qumësht, pak kripë dhe përgatisim petë byreku . Një pjesë të petëve i pjekim. Lyejmë fundin e një tepsie me gjalpë të shkrirë , shtrojmë 2 fije petë duke i spërkatur me gjalpë dhe mbi këto shtojmë petë të pjekura e të thyera . Mishin e zjerë (mund të përdorët mish koke bagëtish) e ndajmë në fije, hedhim vezët e rrahura, qumështin, niseshtenë , kripë e piper. Masën e përtuar e hedhim në tepsinë me petë dhe sipër i shtojmë copa nga petët e mbetura e të pjekura. E spërkasim me gjalpë dhe e pjekim në furrë të nxehtë (200-250 °C) për 35-40 minuta. Shërbehet i ngrohtë.

KULLURE ME MJALTE

Normativa për 5 persona: Miell, 2 filxhan çaji; Vaj, 100 gr; Mjalt, 150 gr; Sheqer, 150 gr; Qumësht, 150 gr; Portokalle, 1 koker; Pak sodë buke, kanëlle e karafil.

Përgatitja :

Hedhim yndyrën në një enë inoksi, e rrahim sa të zbardhet, shtojmë një pjese sheqer, lekuren e portokallit të grire në rende, lëngun e saj, karafil, kanëlle, qumështin dhe i për zejme. Shtojmë gradualisht miellin me pak sodë buke dhe e punojmë sa të behet një mase brumi si për byreke.

E shtojmë në një pllake mermeri ose tepsi dhe e presim duke i dhenë forma sipas dëshires. I vendosim në tave dhe i pjekim në furrë mesatare për 20 minuta.

Nderkohe për gatisim sherbetin me mjalte e sheqerin e mbetur, e mbasi ftohet pak për velojme kulluret.

Shërbehen në pjate me pak sheqer.

VITAMINAT MË KRYESORE JANË

- Vitamina A , që ndikon në sytë dhe flokët gjendet në vajin e peshkut, karrotat, vezët etj.
- Vitamina B Kompleks (13 vitamina) që ndihmon metabolizmin dhe ndikojnë tek lëkura gjenden tek drithërat, orizi, perimet etj.
- Vitamina C , që ndihmon në mbrojtjen e lëkurës dhe lufton infeksionet gjendet tek agrumet , perimet etj.
- Vitamina D , që mbron dhëmbët , kockat , thonjt , gjendet tek peshku , vezët , margarina . Gjithashtu nëpërmjet rrezeve të diellit etj.
- Vitamina E , që ndihmon qarkullimin e gjakut , gjendet në drithërat , tek luledielli etj.

Josif Mio, Shef Kuzhine Person me aftësi të kufizuara në të shikuar, Berat